- vënia në shfrytëzim e objekteve dhe pronave të Bashkisë duke mundësuar eficientimin e përdorimit të tyre nëpërmjet skemave të partneritetit publik – privat;
- eksplorimi i mëtejshëm skemave të partneriteteve me sektorin privat në ofrimin e shërbimeve publike, si transporti publik, sportet dhe qendrat rekreative, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, pikat e grumbullimit për produktet bujqësore, etj..

Përsa i përket rritjes së TON, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative, Bashkia e Beratit parashikon marrjen e një sërë masash si më poshtë:

- përmirësimin e praktikave në ofrimin e shërbimeve vendore dhe eficientimin e kostove të tyre nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- riorganizimit të disa shërbimeve vendore nëpërmjet eksplorimit të mëtejshëm të skemave të partneritetit me sektorin privat;
- reduktimit të kostove administrative nëpërmjet përmirësimit/rikonstruksionit të objekteve vendore duke mundësuar eficiencën energjitike.

Së fundmi, në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiare si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH, etj.) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

Kjo strategji financiare është prezantuar dhe diskutuar me publikun përgjatë takimeve të zgjeruara të organizuara në kuadër të hartimit të PPV-së dhe ka marrë aprovimin e tij, në funksion të realizimit të vizionit të Bashkisë së Berat:

"Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat e qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture moderne, si një destinacion i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse/pritëse për një rajon të pasur natyror. Koncepti i propozuar për zhvillimit e Beratit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. Këto janë themele të forta, të cilat garantojnë që i gjithë komuniteti të përfitojë sot, duke iu trashëguar njëkohësisht brezave të ardhshëm një territori e mjedis të shëndetshëm e të vetëripërtëritshëm, krahas zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm.

Urbanizimi është një proces dinamik, por i kontrolluar e me rritje graduale në Berat. Ai fokusohet në forcimin dhe konsolidimin e qendrave ekzistuese, si dhe shfrytëzimin e drejtë të hapësirave publike dhe orientimin drejt qendërsive urbane të zhvillimit. Në këtë mënyrë shërbimet sillen më afër komunitetit, në mënyrë efikase nga pikëpamja ekonomike dhe mbi të gjitha, krijohet një klimë e shëndetshme për biznesin, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë. Përmes fuqizimit të ekonomisë rurale së saj, Bashkia Berat synon të konsolidojë profilin si pol rajonal i zhvillimit ekonomik turistik, duke u bërë konkurruese në nivel vendi dhe më gjerë. Duke u mbështetur tek parimet e subsdiaritetit, synohet përforcimi i një rrjeti shumë-qendërsish në territor, të decentralizuara si pole të zhvillimit ekonomik dhe administrativ. Këto qendra të përbëra nga vendbanime cilësore dhe aktivitete ekonomike plotësuese brenda rrjetit, kulmojnë me qytetin e Beratit, ku fokusohet shumica e aktiviteteve urbane dhe e shërbimeve publike e komunitare. Këto shërbime ofrohen me të njëjtin standard për të gjithë banorët, në të gjithë territorin e bashkisë, me qëllim zvogëlimin e diferencës urbane-rurale sa i përket ofrimit të infrastrukturës fizike, arsimit, shërbimit shëndetësor, si dhe mundësive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të natyrës urbane e rurale.

Një nga asetet më me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktivë në tregun e punës. Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat"

Për hartimin e PIK është marrë në konsideratë edhe kuadri ligjor përkatës:

- Ligji 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore";*
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";* ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012
- Ligj nr. 57/2016 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2015 *"Për Buxhetin e vitit 2016";*
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore";*
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e Taksave Vendore"*;
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 *"Për disa ndryshime në ligjin 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore";*
- Ligji nr. 142/2015 *"Për ndryshime dhe amendime në ligjin nr. 9632";*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

- Ligji nr. 10117, dt. 23.04.2009; ligji 10146, dt. 28.09.2009; ligji nr. 10073, 09.02.2009 *"Per disa ndryshime në ligjin nr. 9632, dt. 30.10.2006 mbi sistemin e taksave vendre.";*
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *"Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*;
- Ligji 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i amenduar;
- Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";*
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015 *"Për miratimin e Rregullores për Planifikimin e Territorit";*
- Udhëzim nr.4, datë 29.02.2016 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019".*
- Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit"*
- Udhëzim nr. 1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari"*
- Udhëzim nr. 34, datë 28.12.2015 *"Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016"*
- Udhëzim nr. 7/1, datë 28.02.2014 *"Për përgatitjen e buxhetit vendor"*
- Udhëzim nr. 3, datë 16.01.2015 *"Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit""*
- Udhëzim nr. 7, datë 11.02.2015 *"Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limitit të angazhimeve"*
- Udhëzim nr. 8, datë 29.03.2012, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm"*

2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojës së Bashkisë së Beratit për investime kapitale është bërë nëpërmjet ndjekjes së hapave si më poshtë:

- Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime (shiko Tabela 1.). Është vlerësuar gjendja e infrastrukturave dhe shërbimeve të ndryshme publike dhe është grumbulluar informacion në lidhje me moshën, gjendjen, historinë e mirëmbajtjes dhe koston e zëvendësimit të infrastrukturave/shërbimeve publike.
- Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjikë të parashikuara në SZHT-në e Bashkisë: si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese: krijimi i zonave të gjelbra, strehimi social, krijimi i zonave të reja të parkimit, etj.
- Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë, për të mundësuar përditësimin e PIK, lidhjen e tij me dokumentet e tjera financiare (PBA dhe buxheti vjetor), dhe krijimin e një panorame sa më të plotë në lidhje me investimet kapitale në Bashki.

Tabela 1. sjell një panoramë të situatës në lidhje me nevojën për infrastrukturë dhe shërbimeve publike në bashki, referuar aksesit që banorët kanë në to, për çdo njësi administrative.

Kësaj panorame i shtohet plani i veprimit i hartuar në kuadër të SZHT-së, në të cilin janë identifikuar projektet dhe ndërhyrjet kryesore kapitale për realizimin e objektivave strategjike, si dhe lista e investimeve kapitale prioritare të miratuar së bashku me buxhetin e vitit 2016. Mbi këtë bazë është ndërtuar tabela e projekteve kapitale e cila përmbledh informacionin në lidhje me: (i) titullin e projektit, (ii) programin dhe objektivin strategjik në të cilin kontribuon realizimi i projektit; (iii) vendndodhjen gjeografike dhe administrative; (iv) vlerën e projektit; (v) kohën e zbatimit të tij; si dhe (vi) burimin e financimit.

Tabela 1. Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Berat me shërbime vendore

	STREHIM				
	Berat	**Velabisht**	**Otllak**	**Sinjë**	**Roshnik**
Sipërfaqja – strehimi i shërbyer (ha)	175.8	88.3	213.6	219.5	230.8
Sipërfaqja – strehimi i pa shërbyer (ha)	0.2	0.2	0	0	0
Sipërfaqja – strehim të parregullt (ha)					
Sipërfaqja totale – strehimi (ha)	176	88.5	213.6	219.5	230.8

Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Berat, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

3. Analiza financiare


3.1 Analiza financiare 2010-2015

Analiza e aktivitetit financiar për Bashkinë Berat u realizua me përdorimin e të dhënave nga Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit), pranë Ministrisë së Financave. Përdorimi i këtij burimi justifikohet me faktin se arrihet të sigurohen seri kohore për periudhën 2010 – 2015 për të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së re Berat. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative, në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

3.1.1 Të ardhurat

Të ardhurat totale të Bashkisë Berat vlerësohet të kenë ndjekur përgjithësisht një prirje përmirësuese përgjatë periudhës 2010 – 2015. Norma mesatare vjetore e rritjes së të ardhurave gjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë rreth 5.1%, edhe pse me luhatje të ndjeshme nga viti në vit. Në total, të ardhurat në dispozicion të Bashkisë Berat janë luhatur në intervalin 0.9 – 1.4 miliard lekë. Në vitin 2015, burimet financiare në dispozicion të Bashkisë Berat shënuan një vlerë prej 1.1 miliard lekë, në rënie me rreth 22.4% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, në dy vitet e fundit të periudhës në analizë, mjetet financiare kanë shënuar një rritje substanciale në terma nominalë krahasuar me periudhën paraardhëse.

Figura 4. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Në linja të përgjithshme, përcaktues i kahut të zhvillimeve në të ardhurat totale për Bashkinë Berat rezulton të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare[1]. Megjithatë, përgjatë dy viteve të fundit kahu i zhvillimeve në të ardhurat totale është përcaktuar nga ecuria e të ardhurave vendore. Kjo pasi, gjatë këtyre dy viteve ka një rritje të ndjeshme të të ardhurave nga fonde të trashëguara. Përgjatë periudhës në analizë, të ardhurat totale u përbënë mesatarisht për rreth

75.0% nga të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përkundrejt 25.0% nga të ardhurat vendore. Pesha e lartë e transfertave ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave bën që, ndryshime të vogla në nivel qendror në lidhje me këtë kategori të ardhurash të kenë efekt të rëndësishëm në sjelljen e të ardhurave totale të Bashkisë Berat, për pasojë lirshmërisë së saj në ndërmarrjen e projekteve të investimeve.

Analiza në terma kontributesh evidenton më së miri këtë prirje të financave të Bashkisë Berat: kontributi i të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare ka përcaktuar më së shumti kahun e zhvillimeve në të ardhurat totale gjatë viteve 2010 – 2013. Nëse në të ardhurat vendore nuk do të konsideronim të ardhurat nga fondet e trashëguara nga bilanci i vitit të mëparshëm, të dhënat do të tregonin për një kontribut përcaktues të transfertave ndërqeveritare në strukturën e të ardhurave totale edhe në peridhën 2014-2015.

Figura 5. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Pavarësia financiare e Bashkisë Berat, matur nga raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave vlerësohet relativisht e ulët përgjatë periudhës 2010 - 2015. Autonomia financiare regjistroi nivelin maksimal në vitin 2014 me rreth 37.0% dhe nivelin më të ulët në vitin 2012 me rreth 21.2%. Të ardhurat vendore në vitin 2015 shënuan një nivel prej rreth 288.0 milionë lekë, në rritje me rreth 45% në terma vjetorë. Rënia vjetore e të ardhurave vendore vlerësohet të jetë gjerësisht rezultat i bazës së lartë krahasuese të një viti më parë (ndikuar prej të ardhurave të trashëguara nga një vit më parë).

Në terma të përgjithshëm, niveli i të ardhurave vendore përcaktohet na masën më të madhe nga performanca e *taksave dhe tatimeve vendore*. Mesatarisht, të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore kanë përfaqësuar rreth 59.7% të të ardhurave totale gjatë viteve 2010 – 2015. Kategoria e dytë me peshën më të lartë në përbërjen e të ardhurave vendore përfaqësohet nga të ardhurat nga *tarifat vendore* të cilat përfaqsojnë mesatarisht 20.0% të tyre. Të ardhurat nga *asetet* vendore, ndonëse në rritje progresive dhe me potencial afatgjatë, përfaqësuan mesatarisht 7.5% të të ardhurave vendore. Kategoria e të *ardhurave e tjera* (të cilat përfshijnë të ardhura nga donacione, hua) zë një peshë mesatare prej 12.8% në totalin e të ardhurave vendore[2].


Figura 6. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Në kategorinë e të ardhurave vendore, të ardhurat nga taksat dhe tatimet, ndër vite, kanë qenë përcaktuesi kryesor i zhvillime. Në vitin 2015, të ardhurat nga kjo kategori shënuan vlerën e 125.8 milionë lekëve, në rënie me rreth 22.9% në terma vjetorë. Rënia në terma vjetorë u materializua në një kontribut negativ të kësaj kategorie në totalin e të ardhurave vendore. Specifikisht, vlen të evidentohet kontributi pozitiv i të ardhurave të gjeneruara nga *taksat e pronës (tokë bujqësore dhe ndërtesa)*, *taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël)* dhe *taksa e ndikimit në infrastrukturë* nga ndërtimet e reja. Taksat e pronës (taksa mbi ndërtesat dhe ajo mbi tokën bujqësore) si dhe taksa e truallit[3] shihen i taksa me kontribut potencial të lartë në rritjen e të ardhurave vendore si dhe përmirësimin e pavarësisë financare të Bashkisë Berat.

Figura 7. Kontributi sipas kategorive në në ndryshimin vjetor të të ardhurave vendore



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashki Berat dhe Co-PLAN, 2016


Të ardhurat nga tarifat vendore kanë qenë të luhatshme ndër vite por, performanca e tyre në total udhëhiqet nga ecuria e të ardhurave nga *tarifa e pastrimit dhe higjenës*. Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i aseteve në dispozicion përbëjnë një element të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave vendore, duke kontribuar pozitivisht në ecurine e të ardhurave vendore. Për më tepër, implementimi i sistemeve për menaxhimin e aseteve mund t'i transformojë ato në një burim akoma më të rëndësishëm financiar për Bashkinë Berat.

Kategoria të ardhurave të tjera duket të ketë fituar terren veçanërisht gjatë vitit 2014 duke dhënë kontribut përcaktues në kahun e zhvillimeve në të ardhurat totale. Kontributi pozitiv dhe në rritje është përcaktuar në masën më të madhe nga të ardhurat e trashëguara nga viti në vit (konvencionalisht të përfshira në të ardhurat e tjera).

Të ardhurat nga *transfertat ndërqeveritare* të Bashkisë Berat, rezultojnë të jenë një element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia në terma financiarë nga kjo kategori të ardhurash kushtëzon planifikimin e shpenzimeve kapitale (investimeve) të Bashkisë Berat. Në vitin 2015, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare shënuan vlerën 810.9 milionë lekë, në rënie me rreth 9.2% krahasuar me një vit më parë (rënie e diktuar më shumë prej bazës krahasuese të lartë të një viti më parë). Sipas elemtëve përbërës, peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga transferta e kushëzuar e cila në vitin 2015 përfaqësoi rreth 68.9% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare (mesatarja 2010 – 2015 është 64.7%). Mesatarisht, rreth 80% e kësaj transferte vjen nga Minsitria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë diktuar prej situatës ekonomike dhe sociale në Bashkinë Berat.

Pas një rritje vjetore të ndjeshme me rreth 17.6% në vitin 2014, niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2015 shënoi rënie me rreth 19.9% krahasur me një vit më parë.

Figura 8. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht 32.4% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare. Teorikisht dhe në ndryshim nga transfertat e kushtëzuara, për këtë kategori të ardhurash pushteti vendor gëzon autonomi të plotë në përdorim (përjashtuar rastet kur qeveria qendrore udhëzon ndryshe). Në praktikë, ky burim të ardhurash rezulton të jetë shumë i rëndësishëm dhe i qenësishëm në tërësinë e mjeteve financiare në dispozicion të Bashkisë Berat. Mesatarisht, niveli i të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar është i krahasueshëm me totalin e të ardhurave vendore (të ardhurat nga taksat, tarifat, asetet dhe të ardhurat e tjera). Në vite të caktuara, të ardhurat nga ky zë tejkalojnë vlerën e të ardhurave vendore, duke u transformuar në një burim financiar të rëndësishëm për Bashkinë Berat. Mesatarisht, për periudhën në analizë, transferta e pakushtëzuar rezulton të ketë qenë më e lartë në terma nominalë se totali i të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta të bashkisë, ndonëse në dy vitet e fundit ky raport ka ardhur në rënie (si pasojë e rritjes së të ardhurave vendore). Të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara rezultojnë në një kontribut më të ulët ndaj totalit të të ardhurave nga tranfertat ndërqeveritare dhe paraqiten të luhatshme në kohë (si pasojë e ndryshimeve legjislative të ndodhura).


3.1.2 Shpenzimet

Në përputhje me nivelin e të ardhurave totale, Bashkia Berat realizon shpenzime për të siguruar vijimësinë institucionale, ushtrimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe kompencave të përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 *"Mbi vetëqeverisjen vendore"*, në territorin në adminsitrim përcaktuar nga ligji nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërsië"*.

Gjatë vitit 2015, shpenzimet totale të Bashkisë Berat shënuan një vlerë prej 1.3 miliard lekë, në rënie me rreth 1.7% krahasuar me shpenzimet e kryera një vit më parë. Në përgjithësi, ecuria e totale e shpenzimeve duket të ketë qenë e luhatshme ndër vite dhe rënia e shënuar në vitin 2015 të jetë rezultat i bazës së lartë krahasuese të vitit 2014 (norma vjetore e rritjes së shpenzimeve në këtë vit ishte 42.3% ose rreth 418.5 milionë lekë). Nisur nga fakti se viti 2015 u karakterizua nga ndryshime të mëdha, Bashkia Berat u përball me një situatë në të cilën, territori nën administrim dhe popullsia për tu shërbyer u rritën ndjeshëm, të gjitha këto të përkthyeshme në terma financiarë. Në këtë kontekst, nevoja për mjete financiare rezulton të jetë e lartë si për shpenzime administrative ashtu dhe për shpenzime kapitale, veçanërisht në njësitë administrative (ish-komunat) që iu bashkëngjitën Bashkisë së vjetër Berat.

Ndër vite, struktura e shpenzimeve të Bashkisë Berat rezulton të jetë dominuar nga shpenzimet operative dhe ato të personelit (paga dhe sigurime). Shpenzimet operative të Bashkisë Berat mesatarisht përfaqësuan rreth 56.7% të shpenzimevet totale të kryera gjatë viteve 2010 - 2015. Në vitin 2015, shpenzimet operative shënuan një vlerë prej rreth 686.6 milionë lekë, në tkurrje me rreth 8.6% krahasuar me nivelin e tyre të një viti më parë. Kategoria e dytë e shpenzimeve me peshë më të madhe ndaj totalit të shpenzimeve, ato të personelit, përfaqësuan mesatarisht rreth 23.1% ndaj totalit të shpenzimeve përgjatë periudhës 2010 – 2015. Në vitin 2015, shpenzimet për personelin rezultojnë të jenë reduktuar me rreth 6.3% në terma vjetorë, duke përfaqësuar rreth 18.0% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2015.


Figura 9. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Në total, shpenzimet korente (shpenzime personeli dhe operative) përfaqësuan mesatarisht rreth 79.8% të shpenzimeve totale të ndërmarra nga Bashkia Berat për periudhën 2010 – 2015. Ndonëse me peshën më të madhe ndaj totalit të shpenzimeve, ecuria e tyre ndër vite tregon për një prirje rënësë veçanërisht gjatë dy viteve të fundit. Kategoria e shpenzimeve kapitale përfaqësoi mesatarisht rreth 20.2% të shpenzimeve totale të Bashkisë Berat përgjatë periudhës 2010-2015. Pas vitit 2013, shpenzimet kapitale të kryera nga Bashkia Berat u mëse dyfishuan në vitin 2014 dhe shënuan rritje me rreth 14.8% në vitin 2015. Pavarësisht burimit të financimit, në Bashkinë Berat, shpezimet kapitale kanë zënë një peshë të rëndësishme ndaj totalit të shpenzimeve, duke sinjalizuar qartazi një orientim në përbushjetë objektivave strategjikë të saj.

Figura 10. Kontribute sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Analiza në terma kontributesh konfirmon rëndësinë e shpenzimeve administrative (personel dhe operative) përgjatë periudhës së konsideruar. Ajo që vlen të theksohet është balancimi deri diku i kontributit të këtyre dy kategorive në favor të shpenzimeve kapitale. Kështu, duke filluar prej vitit 2014, vihet re një rritje e qenësishme e shpenzimeve kapitale dhe kontribut në kahun pozitiv i tyre në shpenzimet totale.

2.1.3 Teprica operative neto dhe buxheti kapital

Teprica operative neto vlerësohet të ketë qenë pozitive dhe e qendrueshme përgjatë periudhës 2010-2015. Në terma nominalë tëprica operative është luhatur në nivelin 99.1 – 395.4 milionë lekë. Në vitin 2015, teprica operative rezultoi në rreth 147.1 milionë lekë, në rënie me rreth 62.8% në terma vjetorë. Ky nivel i tepricës operative përfaqëson rreth 13.6% të të ardhurave operative të Bashkisë Berat në vitin 2015 dhe sinjalizon për një orientim të qartë drejt ndërmarrjes së investimeve kapitale. Për sa kohë që aksesi në burimet financiare nga grantet konkurruese, burimet ndërkombëtare dhe forndet e donatorëve paraqesin një parashikueshmëri të ulët, teprica operative (dhe teprica operative neto) përbëjnë burimin kryesor mbi bazën e të cilit të ngrihen parashikimet për financimin e projekteve kapitale.

Figura 11. Teprica operative neto (TON)




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Buxheti kapital në dispozicion të Bashkisë Berat do të përcaktohet si shuma e mjeteve financiare nga teprica operative, të ardhruat kapitale nga shitja e aseteve, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga huaja, donacionet dhe të ardhura nga taksa të përmirësimit apo instrumentë të tjerë të posaçëm të zhvillimit. Të gjitha këto përbëjnë atë që gjerësisht konisderohet si buxhet kapital dhe që për Bashkinë Berat rezulton të ketë shënuar vlera pozitive përgjatë periudhës 2010 – 2015.

Shpenzimet kapitale të ndërmarra nga Bashkia Berat gjatë periudhës 2010 – 2015 kanë qenë në mënyrë konstante lehtësisht më të larta krahasuar me buxhetin kapital në dispozicion. Në vitin 2015 kjo gjë është edhe më evidente, ku shpenzimet kapitale rezultojnë rreth 2.7 herë më të larta

se të ardhurat kapitale. Kështu, të ardhurat apo buxheti kapital për vitin 2015 rezultoi në rreth 162.4 milionë lekë përkundrejt një niveli shpenzimesh kapitale pres rreh 447.7 milionë lekësh.


Figura 12. Të ardhura dhe shpenzime kapitale



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Shpërndarja sipas programeve buxhetore e buxhetit kapital përgjatë periudhës 2010 - 2015 pasqyron dhe orientimin strategjik të bashkisë në kohë. Në vitet 2010 – 2015, investimet kapitale ishin të përqëndruara në programin buxhetor "çështjet ekonomike" (pavarësisht burimit të financimit) ku përfshihen investimet e lidhura me infrastrukturën rrugore. Programi buxhetor i arsimit ai i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit gjithashtu rezultojnë të kenë qenë destinacion i një pjese të shpenzimeve kapitale të ndërmarra nga Bashkia Berat.

Figura 13. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare

Identifikimi dhe vlerësimi i projekteve kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjik të SZHT-së, të reflektuar gjithashtu edhe në propozimet e PPV-së. Referuar pamundësisë së financimit të të gjithë projekteve të identifikuara në tabelën përmbledhëse të nevojave për investime kapitale, është bërë procesi i prioritarizimit dhe përzgjedhjes së projekteve të investimeve mbi bazën e një sërë kriteresh të dakordësuara me aktorët. Kriteret marrin në konsideratë tre çështje kryesore: (i) koston e investimit; (ii) jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit; (iii) koston e mirëmbajtjes.

Mbi bazën e këtyre tre çështjeve lista e kritereve që investimet kapitale duhet të plotësojnë në procesin e prioritarizimit të tyre është si më poshtë:

- kontributi i projektit në prioritetet strategjike: sa dhe si kontribuon projekti në arritjen e objektivave strategjik;
- natyra e projektit: a ndikon projekti në parandalimin/eleminimin e një situate urgjente/të rrezikshme;
- statusi i projektit: a është projekt në vazhdim apo projekt i ri dhe si është identifikuar;
- vendndodhja gjeografike/administrative: cila është zona e mbuluar nga projekti dhe në cilën njësi administrative kontribuaon/shtrihet ai;
- kohëzgjatja e shlyerjes së kostos së projektit: a mundet projekti të gjenerojë të ardhura në buxhetin vendor? Kur dhe për sa kohë mund të ndodhë kjo?;
- mundësia e financimit të projektit: a financohet projekti prej buxhetit vendor kapital, apo prej programeve të qeverisë qendrore (QQ)/donatorëve/etj).

5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe të objektivave strategjikë të përshkruar në Strategjinë e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Berat, rezulton thelbësor përkthimi në terma sasiorë (monetar) i tyre. Për këtë qëllimin, projeket e investimeve sipas programeve kuantifikohen (në vlerë) dhe shpërndahen ndër vite (fazohen në kohë). Materializimi i projekteve të investimeve në përmbushje të vizionit të Bashkisë Berat varet shumë nga buxheti kapital apo mjetet financiare në dispozicion të bashkisë.

5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Parashikimi i të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 është marrë nga plan buxheti i Bashkisë së Beratit për vitin 2016. Për periudhën 2017 – 2019, parashikimet u morrën nga Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2017 – 2019 dhe mbi bazën e supozimeve të PBA-së seritë kohore u zgjatën deri në vitin 2020. Për periudhën 2020 – 2030, parashikimet u kryen duke konsideruar trendin e përgjithshëm të ndjekur nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së mëparshme, normat rritëse të parashikuara në PBA 2017 – 2019, parashikimet e përgjithshme për treguesit makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave.

Parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet vendosen në një kontekst makroekonomik të qendrueshëm i cili karakterizohet nga:

- Normë inflacioni e qëndrueshme dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për 3%;
- Kurs këmbimi me valutat kryesore i qendrushëm pa goditje permanente dhe të qenësishme;
- Rritje e moderuar e popullsisël
- Rritje nominale dhe reale e ekonomisë pranë vlerës potenciale;
- Rënie e ngadaltë por progresive e papunësisë;
- Tregues fiskalë (defiçit buxhetor dhe borxh qeverie) pranë niveleve të përshkruara nga Traktati i Maastricht-it;
- Qendrueshmëri e bilancit të pagesave (llogari korente dhe financiare).

Normat e rritjes së treguesve të ndryshëm për të ardhurat dhe për shërbimet do të aplikohen në mesataren rrëshqitëse të 5 viteve paraardhëse.

Tabela 2. Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave

	2021-2025	2026-2030
Taksa dhe tatime	+10.0%	+10.0%
Tarifa vendore	+10.0%	+5.0%
Asete	+10.0%	+10.0%
Të tjera	+10.0%	+5.0%
Transferta e kushtëzuar	+7.0%	+10.0%
Transferta e pakushtëzuar	+10.0%	+10.0%
Transferta specifike	-	-
Taksa dhe tatime të ndara	+10.0%	+10.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga norma mesatare e rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tatimet, supozimet e aplikuara për periudhën 2016-2020 dhe niveli aktual i mbledhjes së tyre vlerësohet se një normë rritjeje prej 10% në fazën e parë dhe të dytë është e përshtatshme. Përsa i përket tarifave, në fazën e parë synohet rritje me rreth 10% dhe në të dytën 5%. Të ardhurat nga asetet vlerësohen me potencial të lartë për rritjen e të adhurave të Bashkisë Berat dhe përmirësimi në menaxhimin e tyre do të mund të përkthehej në një rritje të të ardhurave me 10% në fazën e parë dhe të dytë. Në lidhje me transfertat ndërqeveritare, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme legjislative (ligji për financat vendore) vlerësohet që transferta e kushtëzuar të rritet me 7% në fazën e parë 2021 – 2030 dhe me rreth 10% në fazën e dytë të konsideruar. Duke filluar prej vitit 2021, transferta specifike vlerësohet të mos jetë më si instrument nisur nga fakti se në harkun e pesë viteve pas marrjes së funksioneve të reja ato të jenë përbrendësuar nga Bashkia Berat dhe fondet për to do të jenë të përfshira në totalin e transfertës së kushtëzuar. Ndërkohë, transferta e pakushtëzuar të rritet me 10% për të njëjtat periudha. I njëjti arsyetim vlen edhe për të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara.

Në lidhje me ecurinë e shpenzimeve, Bashkia Berat do të ndjekë një politikë konservatore dhe do të synojë një orientim të tyre më së shumti në financimit e projekteve të investimeve.


Tabela 3. Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve

	2021-2025	2026-2030
Personel	+2.0%	+3.0%
Operative	+2.0%	+1.0%
Kapitale	+5.0%	+5.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Shpenzimet për personelin vlerësohet të rriten me rreth 2% në fazën e parë dhe me rreth 3% në fazën e dytë. Rritja e efieciencës dhe efikasitetit në menaxhimin e Bashkisë si dhe nevojat për investime, vlerësohet një rritje e moderuar me 2 dhe 1% e shpenzimeve operative të Bashkisë Berat. Nga ana tjetër, moderimi në shpenzime korente do të pasqyrohet në rritje të nivelit të investimeve me 5% përgjatë periudhës 2021-2030.

Figura 14. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në total, vlerësohet se Bashkia Berat do të ketë një nivel të ardhurash të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara. Ky skenar mund të konsiderohet si një variant neutral, ndjekës i prirjeve historike (deri diku të moderuar) të treguesve.

5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital

Në vijim të parashikimeve për të ardhurat dhe për shpenzimet, llogarisim tepricën operative neto për të gjithë periudhën e konsideruar. Për periudhën 2016-2030, vlerësohet se teprica operative e Bashkisë Berat do të jetë pozitive dhe në terma sasiorë e konsiderueshme. Kështu, për periudhën 2016-2020, teprica operative do të jetë pozitive duke u vlerësuar në mesatarisht rreth 53.8 % e të ardhurave korente. Më tej, në periudhën 2021-2025 teprica operative vlerësohet të zgjerohet disi, në mesatarisht 58.0% e të ardhurave korente. Konsolidimi i Bashkisë Berat si në terma insitucionalë ashtu dhe funksionalë do të materializohet në një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe tepricë operative pozitive, e vlerësuar në rreth 63.0% të të ardhurave korente të parashikuara për periudhën 2026-2030.


Figura 15. Parashikimi i tepricës operative neto



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Teprica operative së bashku me të ardhurat kapitale japin buxhetin kapital për periudhën e zgjedhur në dispozicion të Bashkisë Berat për të ndërmarrë dhe realizuar investimet kapitale të synuara.

Figura 16. Parashikimi i buxhetit kapital, 2016 – 2030



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në vijim të ndarjes së re administrative-territoriale dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia e re e Beratit përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së taksueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative).

Bazuar në të dhënat financiare historike, parashikimet e përfshira në dokumentin e PBA-së, supozimeve të ndërmarra për parashikimin e zërave kryesorë të të ardhurave dhe shpnezimeve rezulton një buxhet kapital pozitiv në dispozicion të Bashkisë Berat. Në terma nominalë, buxheti kapital në dispozicion për financimin e projekteve të investimeve vlerësohet të ndjekë një prirje rritëse në kohë si pasojë e përmirësimit të menaxhimit fiskal dhe financiar të Bashkisë. Megjithatë, diferencat ekzistuese në nivelin e ofrimit të shërbimeve, zhvillimit ekonomik dhe pabarazitë sociale midis njësive adminsitrative përbërëse kërkojnë një fluks të lartë investimesh për të siguruar deri diku zbutjen e tyre. Ndaj, krahas buxhetit kapital në dispozicion të bashkisë, energji të mëtejshme do të duhet të orientohen në gjetjen e burimeve financiare alternative: huatë bankare nga sistemi bankar vendas (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërorë të ofruara në baza konkurrenciale (FZHR, FSHZH, AZHR etj.), fondet nga burime ndërkombëtare (IPA, BB) apo donatorë të ndryshëm (USAID, KfW etj).

6. Fishat e projekteve kapitale[4]

FISHË PROJEKTI 1 (O3P2_PR2)	
Titulli i projektit	PR2: Rikonstruksion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit
Sfondi i projektit	Disa nga akset kryesore të cilat mundësojnë lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme të qytetit të Beratit, kanë shafqur shenja amortizimi nga përdorimi ndër vite. Kjo gjë ka shkaktuar vështirësimin e kalimit të qytetarëve me automjete dhe kalimin e këmbësorëve nga dëmtimi ose mungesa e trotuarëve në disa segmente përgjatë këtyre aksseve. Në total janë 8.7 km rrugë të amortizuara të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu cilësia e ajrit është një problem për qytetarët që banojnë ose ushtrojnë aktvitetin ekonomik pranë këtyre akseve rrugore.
Përshkrimi i projektit	Rikonstruksion i akseve rrugore të amortizuara në qytetin e Beratit: • Bulevardit "Republika"; • Segmenti rrugor që nis nga stadiumi i vjetër – stadiumi "Tomorr" dhe sheshit përpara stadiumit; • Segmenti rrugor qëndër e qytetit – Uznovë; • Rruga "Santa Lucie Filipine"; • Sheshi "Axhensia" (Sheshi i harmonisë Fetare); • Rruga "Muzak Topia"; • Rruga "Gaqi Gjika"; • Rruga në zonën e quajtur "Kodra e Sulmit"; • Rruga "Mihal Komneno"; • Segmenti rrugor Shish-Ura e Re – Shkolla Industriale; • Rrethrrotullimi në segmentin rrugor "Kinoklubi-Ura e Goricës".
Partnerë &Financues	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR, donator
Rezultati i pritshëm	• Lehtësimi i trafikut automobilistik; • Rritja e aksesit; • Përmirësimi i cilësisë së ajrit; • Rritja e mirëqënies social-ekonomike;
Objektivi	Objektivi O3: *"Garantimi i aksesit hapësinor"*; Programi P2: *"Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare"*
Veprimet strategjike	• Studimi dhe hartimi i projekteve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në qytet; • Përfshirja dhe bashkëpunimi i komunitetit dhe grupit të biznesit që preken drejtëpërdrejt nga këto projekte; • Kryerja e proçeseve prokuruese dhe/ose aplikimi për fonde, sipas rastit; • Lobimi për fonde; • Zbatimi i projekteve.
Rreziqet	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Berat dhe grupeve të interesuara.
Faza e projektit	Në proces
Kosto financiare	43,662,915.0 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër



FISHË PROJEKTI 2 (O3P2_PR3/PR4)	
Titulli i projektit	PR3: Rikonstruksion i rrugës Berat-Drobonik; PR4: Rikonstruksion i rrugës Sinjë-Mbjeshovë, i rrugës në fshatin Mbolan, i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë).
Sfondi i projektit	Në disa fshatra të njësisë Sinjë e Velabisht është evidentuar nevoja për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore. Disa nga segmentet rrugore të cilat lidhin fshatrat ndërmjet tyre janë amortizuar për shkak të përdorimit ndër vite. Duke vështirësuar aksesin ndaj shërbimeve sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Gjatësia në total e segmenteve rrugore që propozohet ndërhyrja është 28.2 km.
Përshkrimi i projektit	Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse ndërmjët fshatrave në njësitë Velabisht e Sinjë: • Rikonstruksion i rrugës Berat – Drobonik (Njësia Velabisht) • Rikonstruksion i segmentit rrugor Bilçe- Malinat (Njësia Velabisht) • Rikonstruksion i rrugës Sinjë – Mbjeshovë (Njësia Sinjë) • Rikonstruksion i rrugës në fshatin Mbolan (Njësia Sinjë) • Rikonstruksion i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë) • 6. Ndërtim i mureve mbajtëse të rrugës Berat-Bilçë
Partnerë & Financues	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR, FSHZH, Donatorë të ndryshëm
Rezultati i pritshëm	• Rritja e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet njësive jo urbane me qytetin e Beratit • Rritja e aksesit ndaj shërbimeve që ofrohen në qytetin e Beratit • Rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike për banorët në zonat jo urbane
Objektivi	Objektivi O3: *"Garantimi i aksesit hapësinor"*; Programi P2: *"Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare"*
Veprimet strategjike	• Hartimi dhe rakordimi me planet kombëtare të transportit dhe projektet e qeverisë qëndrore: • Hartimi i projektit • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde • Përfshirja dhe bashkëpunimi me grupet e interesit (Biznesi, komuniteti etj) • Hartimi i projekteve teknike dhe kryerja e proçesit të prokurimit, ose aplikimi për fonde sipas rastit • Zbatimi i projekteve.
Rreziqet	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese, çon në mos përmbushjen e objektivave.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm
Kosto financiare	220,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 3 (O3P1_PR1)	
Titulli i projektit	PR1: Ndërtimi i Bypass të qytetit të Beratit [Qeveria Qendrore]
Sfondi i projektit	Plani i Përgjithshëm Vendor i hartuar në vitin 2010 parashikon një unazë në kodrat veriore të qytetit të Beratit me një gjatësi afërsisht prej 8 km. Në vitin 2012, Këshilli Bashkiak i Beratit aprovoi një projekt-ide të *By-Pass*-it të propozuar nga Infra Trans Projekt Ltd, Ark-Tek sh.p.k. dhe shoqërisë spanjolle GPO. Projekti i ri parashikon një tunel 1.2 km nën kodrën e Goricës dhe një urë lidhëse me lagjen e Uznovës, me një gjatësi totale prej 4.4 km.
Përshkrimi i projektit	Ndëtimi i unazës (*By-Passit*) të qytetit të Beratit të bazuar nga plani i miratuar i këshillit bashkiak. Përfshirja e projektit ekzistues në planin e ri të përgjithshëm vendor si dhe bashkërendimin me projektin fitues të ishullit të Beratit.
Partnerë & Financues	Bashkia Berat, Ministria e Transportit, Sektori Privat, FZHR, FSHZH, Donator
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i nivelit të ndotjes; • Rritje e vizitorëve nga lehtësimi në qarkullim;
Objektivi	Objektivi O3: *"Garantimi i aksesit hapësinor"*; Programi P1: *"Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat në funksion të trafikut ndërqytetas".*
Veprimet strategjike	• Sigurimi i miratimit nga UNESCO për pjesën e projektit që kalon në zonën buferike të lagjes historike të Goricës; • Rivlerësimi dhe përfshirja e projektit në planin e përgjithshëm vendor • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde;
Rreziqet	• Rishikimi i projektit dhe rritje e kostos (zgjatim i urës) në kuadër të ndryshimeve të planit për rehabilitimin e shtratit të Osumit (Projekti i ishullit të Beratit); • Rreziqe në zhvendosje të dherave të kodrës të mbrojtur të Goricës gjatë punimeve.
Faza e projektit	Investim i qeverisë qendrore
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm - Afatgjatë
Kosto financiare	3,906,000,000.0 Lekë (rreth 28 milionë euro)

FISHË PROJEKTI 4 (O2P5_PR12)	
Titulli i projektit	PR12: Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane
Sfondi i projektit	Dëmtime të shtratit, brigjeve dhe zonës ripariane, të shkaktuara nga proçeset gjeologjike e gërryese të vetë lumit, si dhe ato nga ndërhyrja e njeriut në territor nëpërmjet bujqësisë e urbanizimit, janë vënë re përgjat gjithë rrjedhës së lumit. Ajo ka pësuar dëmtime të theksuara duke u ngushtuar, me mungesa të bimësisë së nevojshme mbrojtëse, ose e kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.
Përshkrimi i projektit	Studimi dhe zbatimi i punimeve të rigjenerimit të shtratit të lumit, brigjeve të tij dhe zonës ripariane për të parandaluar humbjen e tokës dhe ndotjen e ujrave të lumit dhe akuifereve. Projketi synon ndërhyrjen përgjatë gjithë shtratit të lumit Osum që kalon në territorin e Bashkisë Berat. Duke e ndarë në tre segmente të kryesore sipas karakterit të tokës. **Segmenti i parë**, nis në pjesën veriore të Bashkisë Berat dhe përfundon në kufirin e zonës industriale. Ky segment shtrihet përgjatë tokave bujqësore.**Segmenti i dytë**, nis nga zona industriale (ish kombianti) dhe përfundon në daljen e qytetit, Uznovë. Ky segment shtrihet përgjatë zonës urbane e industriale. **Segmenti i tretë**, nis nga Uznova e përfundon në kufirin e Bashkisë Berat, në juglindje. Ky segment shtrihet përgjatë zonës natyrore dhe bujqësore.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit, Komuniteti, FSHZH, FZHR, Banka Botërore, Donatorë të ndryshëm
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i peizazhit të lumit; • Parandalimi i humbjes së tokës bujqësorë dhe natyrore; • Minimizimi i shkëmbimit të ndotjes ujore nga tokat bujqësore dhe zonat urbane për tek trupi ujor; • Territoret urbane përgjatë lumit do të mbrohen nga përmbytja; • Peizazhi i waterfront-it do të përmirësohet.
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P5: *"Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor".*
Veprimet strategjike	• Hartimi i koncept-idesë dhe lobimi për fonde; • Hartimi i projektit dhe aplikimi për fonde, sipas rastit; • Kryerja e punimeve për rehabilitimin e zonës ripariane dhe sistemimin e e brigjeve; • Rehabilitimi i pikave të ndërhyjeve dëmtuese të njeriut dhe eleminimi i burimeve ndotëse përgjtë segmentit ku zbatohet projekti.
Rreziqet	Cështja e konfliktit të pronësisë së brigjeve të lumit mund të rritë koston e projektit dhe të zgjatë kohën e zbatimit të tij.
Faza e projektit	Në proces
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër-Afatmesëm
Kosto e projektit	500,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 5 (O2P6_PR14/15/16/17/18/19/20)	
Titulli i projektit	PR14: Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat; PR15: Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të larta, faza e III segmenti Burdullias-lumi Osum, Berat; PR16: Rikonstruksioni i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin dhe ndërtim i rrjetit në fshatra (Mbreshtan, Sinjë, Lapardha, Otllak); PR17: Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Velabisht, Duhanas, e Dushnik; PR18: Ndërtim i ujësjellësit në lagjen Prokopi, fshati Paftal, Sinjë; PR19: Studim dhe hapje pusi për ujë të pijshëm në fshatin Mbreshtan, Sinjë; PR20: Rikonstruksion ujësjellësi Roshnik.
Sfondi i projektit	Bashkia Berat ofron aktualisht shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve në qytetin e Beratit dhe pjesërisht në njësinë Otllak. Duke lënë jashtë shërbimit njësitë Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, në të cilat situata e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza paraqitet e vështirë.
Përshkrimi i projektit	Rikonstruksioni i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në qytetin e Beratit dhe njësinë Otllak dhe ndërtimi i sistemit të ujësjllësit dhe kanalizimeve në njësitë Velabisht e Sinjë.
Partnerë & Financues	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR, FSHZH, Donatorë të ndryshëm
Rezultati i pritshëm	• Përdorimi i burimeve ujore si potencial për zhvillimin turistik • Rritja e mirëqënies sociale
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P6: *"Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ si dhe ndërtimi i impantit të trajtimit të ujërave të zeza".*
Veprimet strategjike	• Hartimi i studimit dhe projekteve për ofrimin e këtij shërbimi në zonat më problematike
Rrisqet	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër – Afatmesëm
Kosto e projektit	PR 14 336,000,000.0 Lekë PR 15 100,000,000.0 Lekë PR 16 350,000,000.0 Lekë PR 17 101,968.0 Lekë PR 18 10,000,000.0 Lekë PR 19 5,000,000.0 Lekë PR 20 54,392,984.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 6 (O1P3_PR4)	
Titulli i projektit	PR4: Rikonstruksion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit
Sfondi i projektit	Ndërtimi i godinave në hyrje të qytetit të Beratit është realizuar para viteve 90'. Në këto godina janë evidentuar shenja amortizimi si pasojë e mosndërhyrjeve në përmirësimin e kushteve teknike.
Përshkrimi i projektit	Rehabilitimin e godinave ekzistuese në hyrje të qytetit dhe integrimi me qytetin historik, sipas një projekti të dizajnit urban. Bashkia do të bashkëpunojnë me banorët për t'i angazhuar në hartimin e bashkëfinancimin e projektit që jo vetëm i shton vlerë qytetit, por është edhe proçes i zakonshëm i mirëmbajtjes së banesave nga banorët. Përmes bashkëfinancimit mund të synohet që projekti të hyjë edhe në rritjen e efiçiencës energjitike të ndërtesave të banimit.
Partnerë & Financues	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR, Donator të ndryshëm
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i imazhit dhe hapësirës publike të qytetit. • Rritja e mirëqënies së banorëve që preken drejtëpërdrejt nga ky projekt.
Objektivi	Objektivi O1: *"Zhvillim hapësinor inovativ, cilësor dhe i planifikuar"*; Programi P3: *"Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumentëve financiarë, dizajnit urban dhe PPP-ve".*
Veprimet strategjike	• Studimi i zonës së qytetit duke marrë në konsideratë moshën e objekteve dhe prezencën e elementeve arkitektonikë dhe të efiçiencës energjitike. • Hartimi i projektit arkitektonik dhe konstruktiv • Aplikimi për fonde dhe krijimi i bordit të banorëve dhe ngritja e fondit të bashkëfinancimit • Zbatimi i projektit
Rreziqet	Mungesa e bashkëpunimit të banorëve të prekur drejtëpërdrejt nga ky projekt me Bashkinë Berat dhe mungesa e gatishmërisë për të bashkëfinancuar.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër
Kostot e projektit	150,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 7 (O1P3_PR3)	
Titulli i projektit	PR3: Rikonstruksion i hapësirave urbane në lagjen "Murat Çelebiu"
Sfondi i projektit	Lagjia Murat Çelebiu pozicionohet në pjesën veri perëndimore të qytetit të Beratit dhe karakterizohet nga banesa shumëkatëshe të ndërtuara para viteve 90'. Në këtë zonë mungojnë hapësirat urbane dhe rekreative.
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i hapësirave urbane ndërmjet zonave të banimit.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i imazhit të qytetit. • Rritja e mirëqënies së banorëve që preken drejtëpërdrejt nga ky projekt.
Objektivi	Objektivi O1: *"Zhvillim hapësinor inovativ, cilësor dhe i planifikuar"*; Programi P3: *"Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumentëve financiarë, dizajnit urban dhe PPP-ve".*
Veprimet strategjike	• Studimi dhe hartimi i projektit duke marrë në konsideratë objektet e ndërtuara në këtë zonë. • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde;
Rrisqet	Mungesa e bashkëpunimit të personave që preken drejtëpërdrejt nga ky projekt me bashkinë Berat.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër-Afatmesëm
Kostot e projektit	150,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 8 (O2P7_PR22)	
Titulli i projektit	PR22: Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë
Sfondi i projektit	Parku me pisha në anën lindore të kalasë, i shtrirë në një sipërfaqe prej 8.6 ha, është pjesë e zonës së mbrojtjes së kalasë. Në këtë pjesë të parkut është shumë i dukshëm erozioni si një nga format e degradimit të tokës.
Përshkrimi i projektit	Sistemimi me pisha i parkut në faqen lindore të kalasë së Beratit. Mbjellja e pemëve dhe ndërtimi i infrastrukturave mbrojtëse nga rrëshqitja e tokës.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, Ministria e Mjedisit dhe donator të ndryshëm
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i imazhit të zonës së mbrojtur. • Rritja e mirëqënies së banorëve të vendosur pranë kësaj zone.
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P7: *"Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale".*
Veprimet strategjike	• Studimi teknik/peizazhistik i zonës së qytetit duke marrë në konsideratë monumentet e kulturës dhe zonën e mbrojtur • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde; • Zbatimi i projektit.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër-Afatmesëm
Kostot e projektit	50,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 9 (O2P2_PR3)	
Titulli i projektit	PR3: Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes "Mangalem" (1 6 banesa)
Sfondi i projektit	Lagjia Mangalem është pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore që prej vitit 2008. 16 shtëpi të vendosura në këtë lagje kanë për nevojë restaurim në mënyrë që të parandalohet degradimi dhe të shtohet vlera kulturore e lagjes.
Përshkrimi i projektit	Hartimi i projektit dhe më pas restaurimi i fasadave të 16 shtëpive të vendosura në këtë lagje.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës, UNESCO, Komiteti Veprues i Zhvillimit Turistik të Beratit, Sektori Privat, FZHR
Rezultati i pritshëm	• Përmirësimi i kushteve fizike të objekteve kulturore promovon shtim të numrit të turistëve
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P2: *"Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Goricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik".*
Veprimet strategjike	• Studimi dhe hartimi i projektit duke marrë në konsideratë objektet dhe monumentet e kulturës të mbrojtura; • Hartimi/rishikimi i rregullores arkitektonike të zonës së mbrotjur • Aplikimi për fonde; • Fushatë sensibilizimi për bashkëfinancim nga banorët e banesave përkatëse; • Zbatimi i projektit dhe marketimi.
Rreziqet	Kosto e lartë e projektit dhe mungesa e vullnetit të banorëve për të bashkëpunuar.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër
Kosto financiare	15,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 10 (O5P4_PR4&PR5)	
Titulli i projektit	PR4: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare në fshatin Veternik, njësia Velabisht PR5: Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë (Velabisht), shkollës së mesme dhe ambjenteve sportive në fshatin Sinjë
Sfondi i projektit	Në njësinë Velabisht shërbejnë nëntë shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në njësisë Sinjë shërben një shkollë e mesme. Shkolla 9 vjeçare e fshatit Veternik dhe shkolla e mesme në fshatin Starovë janë në gjëndje të amortizuar dhe mungojnë hapësirat sportive. Gjithashtu dhe shkollae mesme në fshatin Sinjë është po në të njëjtën gjëndje. Dhe zhvillimi i aktivitetit mësimor është tepër i vështirë në këto kushte.
Përshkrimi i projektit	Rikonstruksioni i institucioneve arsimore në njësitë Velabisht e Sinjë.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti
Rezultati i pritshëm	• Rritja e performancës në proçesin e mësimdhënies; • Rritja e mirëqënies sociale.
Objektivi	Objektivi O5: *"Infrastruktura e shërbimet sociale"*; Programi P4: *"Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë adminsitrative të Bashkisë Berat".*
Veprimet strategjike	• Të ndërtohen shkolla brenda standarteve të projektimit. • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde.
Rreziqet	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër
Kosto financiare	PR4 38,000,000.0 Lekë PR5 50,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 11 (O2P1_PR2)	
Titulli i projektit	PR2: Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastër e Butrint
Sfondi i projektit	Berati pozicionohet në skaj të një aksi kombëtar dhe aktualisht jashtë korridorit jugor që lidh dy vende kryesore turistike të Gjirokastrës dhe Butrintit me aeroportin dhe qendrën e vendit. Megjithatë Berati gjendet në rrëzë të një zone të thellë malore dhe me vlera të mëdha mjedisore e kulturore. Qyteti i Beratit duhet të shërbejë si porta hyrëse dhe akomoduese e potencialit turistik për këtë zonë dhe në të njëjtën kohë si pikënisja e itinerareve të ecjes në natyrë për të gjithë zonën.
Përshkrimi i projektit	Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastër e Butrint që ta integrojë Beratin në paketat turistike për rajonin jugor. I cili i mundëson turistëve që me automjetet e tyre të vizitojnë tre qëndra historike dhe njëkohësisht të mund të shijojnë peisazhin e bukur të rajonit jugor. Rruga e planifikuar Berat – Memaliaj e përforcon këtë qasje.
Partnerë & Finanuces	Bashkia Berat, FZHR, FSHZH, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Komuniteti, Sektori Privat, Donatorë
Justifikimi i projektit	• Rritja e të ardhurave gjeneruar nga shtimi i numrit të vizitorëve; • Rritja e punësimit në sektorin e turizmit (punime artizanale/ shërbime); • Forcimi i sektorit të hotelerisë nëpërmjet përfshirjes në paketa turistike.
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P1: *"Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kondrinore-malore".*
Veprimet strategjike	• Studimi dhe evidentimi i rrjetit të itenerareve me potencialin më të madh turistik; • Promovimi i idesë dhe lobimi për fonde; • Përgatitja e projektit teknik dhe aplikimi për fonde dhe/ose prokurimi sipas rastit; • Realizimi i zhvillimit të rrjetit të itinerareve; • Konsultime me grupet e interesuara private për hartimin e paketave turistike, thithjen e turistëve dhe krijimin e aktiviteteve mbështetëse përgjatë itinerarit; • Përfshirja dhe bashkëpunimi me bashkitë fqinje.
Rezultati i pritshëm	• Integrimi i Beratit në rajonin jugor turistik; • Shtimi i itenerareve për të krijuar ndërlidhje më të madhe me destinacione turistike të ndryshme; • Evidentimi i Beratit si epiqendër rajonale e turizmit.
Rrisqet	• Mos bashkëpunimi i bashkive fqinje nga perceptimi i projektit si konkurencë; • Mungesa e bashkëpunimit të komunitetit për krijimin e itenerareve natyrore.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër
Kosto financiare	25,000,000.0 Lekë

FISHË PROJEKTI 12 (O2P2_PR4)	
Titulli i projektit	PR4: Restaurimi i godinave te amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri, në zonat historike
Sfondi i projektit	Qendra historike e Beratit i nënshtrohet kërkesave specifike të mirëmbajtjes dhe mbrojtjes nga zjarri si detyrim i statusit të dhënë nga UNESCO. Mirëmabjtja e këtyre objektëve me vlerë siguron atraksionin e vizitorëve dhe zhvillimin e sektorit turistik.
Përshkrimi i projektit	Studimi dhe zbatimi i punimeve të nevojshme për të siguruar integritetin strukturor dhe arkitektonik të pasurive historike, ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtjen ndaj zjarrit. Në zonat historike si lagja "Mangalem", "Goricë" dhe "Kala" me një sipërfaqe përkatësisht 5.8 ha, 2.9 ha dhe 9.4 ha.
Partnerë & Financues	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, FSHZH, UNESCO, donatorë të ndryshëm
Justifikimi i projektit	• Mbrojtja e qendrës historike, e cila përbën një aspekt thelbësor të identitetit të qytetit si dhe të sektorit të tij turistik; • Rreziku i cënimit të statusit ndërkombëtar nga mospërmbushja e detyrimeve.
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P2: *"Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Goricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik".*
Veprimet strategjike	• Hartimi i projektit; • Përcaktimi dhe resaturimi i ndërtesave të degraduara/amortizuara; • Promovimi i projektit dhe lobimi per fonde.
Rezultati i pritshëm	• Rritja dhe konservimi i vlerave historike të qytetit
Rreziqet	• Neglizhenca e autoriteteve për t'i dhënë prioritet resaturimeve apo sistemeve kundra zjarrit.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Aftatshkurtër – Afatmesëm
Kosto financiare	15,000,000.0

FISHË PROJEKTI 13 (O2P8_PR23)	
Titulli i projektit	PR23: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli
Sfondi i projektit	Depozitimi i mbejeve të ngurta aktualisht ndodh në një sipërfaqe prej 9.3 ha pranë lumit Osum. Ky vendgrumbullim jo sanitar ndot lumin dhe shkarkon mbetje gjatë ngritjes të nivelit të lumit. Plani për menaxhimin e mbetjeve urbane i hartuar në 2012-tën evidenton këto problematika.
Përshkrimi i projektit	Vënien në zbatim të politikave të menaxhimit të mbetjeve të ngurta të hartuara ne planin e 2012, si dhe ndërtimin e një landifilli pranë vendepozitimit aktual.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Mjedisit, Komuniteti
Justifikimi i projektit	• Ulja e depozitimeve të mbetjeve të ngurta nëpërmjet përpunimit/ndarjes së tyre përpara depozitimit; • Mbrojtja e mjedisit dhe veçanërisht e lumit nga ndotja;
Objektivi	Objektivi O2: *"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional"*; Programi P8: *"Modernizimi i shërbimit të menaxhimit e integruar të mbetjeve urbane dhe ndërtimi i një landfilli rajonal për manaxhimin e mbetjeve".*
Veprimet strategjike	• Ndërtimi i një landfilli pranë Orizaj me impiantë përpunuse/ndarëse të mbetjeve; • Mbyllja dhe pastrimi i venddepozitimit ekzistues; • Fushata ndërgjegjësimi për ndarjen e mbeturinave dhe riciklimit.
Rezultati i pritshëm	Përmirësimi i peizazhit të lumit dhe ulja e nivel të ndotjes në natyrë. Ulja e emetimeve të gazrave të rrezikshëm në ajër nga fusha aktuale e depozitimit të mbetjeve.
Rreziqet	-
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm – Afatgjatë
Kosto financiare	3,900,000,0O0.0 Lekë (ose rreth 30,000,000.0 ChF)

7. Shtojca

Shtojca 1. Të ardhura Bashkia Berat, 2010 – 2015

	TE ARDHURA (000/Lekë)	2010	2011	2012	2013	2014	2015
A	Taksa vendore	140,414	147,568	135,285	153,197	163,088	125,751
1	Taksa mbi pasurinë	34,308	35,323	35,448	37,900	62,568	45,167
1.1	Taksa mbi ndërtesat	21,023	24,244	25,002	27,462	46,804	38,851
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	13,285	11,079	10,446	10,438	15,764	6,316
2	Taksa mbi biznesin e vogël	53,881	54,353	54,945	43,902	43,083	45,687
3	Taksë tabele	342	312	355	260	246	2,373
4	Taksë reklame	4,062	5,171	3,860	2,834	2,240	-
5	Taksa e regjistrimit e biznesit	627	1,975	2,508	3,683	5,255	-
6	Taksë zënie hapësire publike	5,984	5,093	17,846	17,173	14,156	14,381
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	25,532	28,474	510	6,905	2,084	14,923
8	Taksa e kalimit të pronësisë	824	1,637	835	2,250	2,881	1,545
9	Taksë fjetje në hotel	1,001	1,047	1,126	1,332	2,048	1,675
10	Taska të tjera vendore	13,852	14,184	17,853	36,959	28,524	-
B	Tarifat vendore	43,252	40,475	38,466	35,930	59,193	88,666
1	Tarifë pastrimi	29,455	30,061	29,385	30,912	53,462	49,738
2	Tarifë gjelbërimi						5,186
3	Tarifë ndriçimi						14,928
4	Licenca, leje, autorizime	3,575	1,829	1,857	1,653	898	-
5	Tarifë therrje bagëtie	274	222	234	86	264	
6	Tarifa te tjera te miratuara nga NjA						2,209
7	Tarifë gjuetie dhe peshkimi amator	5,780	2,893	3,046	2,567	4,047	-
8	Të ardhura nga parkimi	3,270	3,923	3,407	433	228	1,350
9	Të tjera (interesa, gjoba)	894	1,202	149	26	7	3,031
10	Të tjera	3	345	388	253	288	12,224
C	Të ardhura nga asetet	15,996	12,120	13,316	19,242	23,327	30,358
1	Të ardhura nga qeratë	5,229	694	3,659	10,003	13,125	9,291
2	Të ardhura nga shitja e aseteve						374
3	Të ardhura nga kopshtet, çerdhet, konviktet	9,003	9,740	8,551	8,235	9,068	9,921
4	Të tjera	1,763	1,686	1,106	1,004	1,133	10,772
D	Të ardhura të tjera	139	6,066	10,870	-	1,006	-
1	Dhurata/Sponsorizime	-	-	-	-	-	-
2	Donacione	139	6,066	10,870	-	1,006	-
3	Kredi	-	-	-	-	-	-
E	Të ardhura të trashëguara	-	-	-	-	276,727	43,130
F	Taksa e tatime të ndara	20,248	22,019	27,705	22,269	16,673	16,673
G	Transferta e pakushtëzuar	248,376	248,046	248,021	249,994	294,039	235,595
H	Transferta e kushtëzuar	475,986	447,795	460,763	514,538	582,131	558,580
1	Ekonomia	1,880	2,342	2,286	2,322	2,370	2,369
2	Transporti dhe infrastruktura	48,601	19,352	54,281	51,497	3,500	21,752
3	Arsimi	35,336	11,801	31,321	41,325	49,967	29,788
4	Kultura	-	26,453	-	-	-	-
5	Shëndetësia	-	2,189	1,962	-	-	-
6	Mbrojtja	10,752	11,680	7,806	8,428	9,267	26,052
7	Përkujdesi social	378,579	370,919	363,108	405,754	496,814	420,234
8	Komisioni qendror i zgjedhjeve	838	3,058	-	5,212	-	-
9	Integrimi Evropian	-	-	-	-	20,213	54,209
10	Zhvillimi Urban						4,177
TOTALI		**944,410**	**924,088**	**934,426**	**995,170**	**1,416,184**	**1,098,753**

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Shtojca 2. Shpenzime Bashkia Berat, 2010 – 2015

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Personel	246,170	249,173	234,857	252,731	266,592	249,807
Operative	573,473	541,141	574,062	609,233	751,133	686,567
Kapitale	171,638	165,567	128,623	127,176	389,879	447,679
Total	**991,281**	**955,882**	**937,542**	**989,140**	**1,407,603**	**1,384,053**

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Shtojca 3. Identifikimi i projekteve kapitale dhe lidhja e tyre me programet dhe objektivat strategjik të zhvillimit

OBJEKTIVI	PROGRAMI	PROJEKTI I INVESTIMIT
O1: Zhvillim hapësinor inovativ, cilësor dhe i planifikuar	O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy qendërsive ekonomike rajonale, pranë njësisë Otllak dhe Velabisht	PR1: Hartimi i PDV-së dhe mundësimi i zhvillimi të zonës ekonomike pranë fshatit Otllak dhe Velabisht
	O1P2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzsituese urbane të njësive administrative	PR2: Rigjenerimi dhe rivitalizmi i qendrave të Njësive Administrative
	O1P3: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumentëve financiarë, dizajnit urban dhe PPP-ve	PR3: Rikonstruksion i hapësirave urbane në lagjen "Murat Çelebiu"
		PR4: Rikonstruksion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit
		PR5: Rikualifikim dhe rikonstruksion i hapësirës Urbane, Lagja "Barrikadë"
		PR6: Rikualifikim dhe rikonstruksion i Parkut "Dëshmorët e Kombit" dhe trotuareve
		PR7: Ndërtim i fushave sportive në lagjet: "A.Xhindole", "Xh. Cekini", "28 Nëntori"
O2: Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm e shumëdimensional	O2P1: Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kondrinore-malore	PR1: Përcaktimi i itinerareve dhe destinacioneve tërheqëse për turizmin në qytet në zonat kodrinore-malore duke krijuar një kalendar veprimtarish vjetore
		PR2: Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastër e Butrint
	O2P2: Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Goricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik	PR3: Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes "Mangalem" (16 banesa)
		PR4: Restaurimi i godinave te amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri, në zonat historike
		PR5: Rikonstruksion i çatisë së Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani"
		PR6: Rikonstruksion i bibliotekës "Vehxhi Buharaja"
	O2P3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar, hotelier dhe informativ për turistët në qytetin e Beratit si dhe përgjatë rrugëve panoramike dhe peizazhistike	PR7: Krijimin e paketave të reja turistike
		PR8: Shtimi i zyrave të informacionit për turistët
		PR9: Krijimi i pikave të shitjes së produkteve artizanale
	O2P4: Mbështetja me infrastrukturat dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësinë Roshnik	PR10: Evidentimi i itinerareve peizazhistike në Roshnik
		PR11: Krijimi i paketave turistike për promovimin e ekoturizmit
	O2P5: Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor	PR12: Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane
		PR13: Menaxhimi i integruar i ujërave të Lumit Osum
	O2P6: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ si dhe ndërtimi i impantit të trajtimit të	PR14: Përmirësimin dhe shtimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat
		PR15: Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave

	ujërave të zeza	të larta, faza e III segmenti Burdullias-lumi Osum, Berat
		PR16: Rikonstruksioni i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin dhe ndërtim i rrjetit në fshatra (Mbreshtan, Sinjë, Lapardha, Otllak)
		PR17: Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Velabisht, Duhanas, e Dushnik
		PR18: Ndërtim i ujësjellësit në lagjen Prokopi, fshati Paftal, Sinjë
		PR19: Studim dhe hapje pusi për ujë të pijshëm në fshatin Mbreshtan, Sinjë
		PR20: Rikonstruksion ujësjellësi Roshnik
	O2P7: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale	PR21: Hartimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave
		PR22: Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë
	O2P8: Modernizimi i shërbimit të menaxhimit e integruar të mbetjeve urbane dhe ndërtimi i një landfilli rajonal për manaxhimin e mbetjeve	PR23: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli
		PR24: Ndërtimi i një stacioni riciklimi
		PR25: Ndërtim te një stacioni transferimi për mbetjet urbane
O3: Garantimi i aksesit hapësinor	O3P1: Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat në funksion të trafikut ndërqytetas	PR1: Ndërtimi i Bypass të qytetit të Beratit [investim i qeverisë qendrore]
	O3P2: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare	PR2: Rikonstruksion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit
		PR3: Rikonstruksion i rrugës Berat-Drobonik dhe segmentit rrugor Bilçe-Malinat (Njësia Velabisht)
		PR4: Rikonstruksion i rrugës Sinjë-Mbjeshovë, i rrugës në fshatin Mbolan, i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë)
	O3P3: Menaxhimi i trafikut lokal përmes sistemit të informacionit dhe ndërhyrjeve pikësorë në infrastrukturë	PR5: Krijimi i sinjalistikës rrugore pajisja me semaforë e kryqëzimeve
		PR6: Shtimi i zonave të parkimeve publike në qytetin e Beratit
	O3P4: Hartimi dhe zbatimi i një plani sektorial të transportit publik të integruar për Bashkinë Berat	PR7: Hartimi i planit sektorial të integruar të transportit
O4: Zhvillim bujqësor e rural	O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkërendim i punës me institucionet qendrore për sistemin e ujërave të larta	PR1: Rehabilitimi i stacionit të elektropompave
		PR2: Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta
		PR3: Mbrojtja nga përmbytjet në zonë. Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse
		PR4: Mbrojtja e shpatit të përroit "Zagorë" në lagjen Uznovë
	O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore nga zhvillimet urbane	PR5: Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore
	O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë përmes PPP-ve dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve	PR6: Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartëzimit të pronave publike, subjekt transferimi në bashki dhe përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike
		PR7: Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore

		PR8: Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat e përshtatshme
	O4P4: Mbarështimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në blegtori e bujqësi	PR9: Hartimi i politikave për kultivimin e tokave bujqësore dhe kullotave nëpërmjet subvencioneve
O5: Infrastruktura e shërbimet sociale	O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale	PR1: Përmirësimi i infrastrukturës së spitalit rajonal dhe plotësimi i nevojave sanitare
	O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ambulancave në njësitë administrative të Bashkisë Berat	PR2: Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në njësitë administrative Otllak, Sinjë, Roshnik dhe Velabisht
	O5P3: Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë, nxitje për arsimin professional dhe universitar	PR3: Ndërtimi i një shkolle profesionale në qytetin e Beratit
	O5P4: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë adminsitrative të Bashkisë Berat	PR4: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare në fshatin Veternik, njësia Velabisht
		PR5: Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë (Velabisht), e i shkollës së mesme dhe ambienteve sportive në fshatin Sinjë
		PR6: Ndërtim i shkollës 9-vjeçare dhe kopështit, Karkanjoz
	O5P5: Zbatimi i programit lokal për strehimin social	PR7: Hartimi i programit vendor për strehimin social në Bashkinë Berat
O6: Fuqizimi i biznesit e sipërmarrjes	O6P1: Mbështetje, marketim, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale	PR1: Organizimi i panaireve vjetore të produkteve vendase në Bashkinë Berat
		PR2: Ndërtimi i tregut ushqimor në funksion të zhvillimit të sektorit të bujqësisë në Otllak
		PR3: Hartimi i Strategjisë së Marketimit të produkteve vendase
	O6P2: Nxitje e sipërmarrësve të rinj për jetësimin e projekteve me ide inovatore për tregun aktual	PR4: Hartimi i politikave për tërheqjen e biznesit të ri novator në Bashkinë e Beratit me anë të lehtësimit të taksave dhe subvencioneve

Burimi: Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Berat, 2016

Shtojca 4. Parashikimi i të ardhurave Bashkia Berat, 2016 – 2030

TE ARDHURAT ANALITIKE (000/Lekë)		2016	2017	2018	2019	2020	2021-2025	2026-2030
A	Taksa vendore	145,699	161,788	165,590	169,243	173,588	192,416	225,966
1	Taksa mbi pasurinë	70,616	77,553	79,308	81,115	82,375		
1.1	Taksa mbi ndërtesat	50,781	52,304	53,874	55,490	56,600		
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	19,069	19,069	19,069	19,069	19,088		
1.3	Taksa mbi truallin	766	6,180	6,365	6,556	6,687		
2	Taksa mbi biznesin e vogël	37,134	38,248	38,248	38,248	39,395		
3	Taksë tabele	3,247	3,896	4,052	4,214	4,383		
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	30,000	33,000	34,320	35,693	37,121	40,338	47,430
8	Taksa e kalimit të pronësisë	3,000	3,135	3,229	3,326	3,426		
9	Taksë fjetje në hotel	1,700	1,955	2,033	2,115	2,220		
10	Taska të tjera vendore	2	4,000	4,400	4,532	4,668		
B	Tarifat vendore	129,358	130,721	135,442	140,352	145,451	159,841	174,893
1	Tarifë pastrimi	55,256	60,782	62,605	64,483	66,418		
2	Tarifë gjelbërimi	10,845	11,930	12,526	13,152	13,810		
3	Tarifë ndriçimi	22,015	24,217	25,427	26,699	28,034		
4	Tarifë therrje bagëtie	320	352	370	388	400		
5	Tarifë për zënien e hapësirave publike	15,835	13,618	14,108	14,616	15,142		
6	Tarifa te tjera te miratuara nga NjA	1,000	1,100	1,155	1,213	1,273		
7	Të ardhura nga parkimi	2,551	2,679	2,812	2,953	3,101		
8	Të tjera (interesa, gjoba)	10,111	10,212	10,314	10,417	10,522		
9	Të tjera	11,425	5,833	6,124	6,430	6,752		
C	Të ardhura nga asetet	39,691	45,477	50,672	55,913	57,317	60,341	71,214
1	Të ardhura nga qeratë	11,824	12,125	12,366	12,614	12,992		
2	Të ardhura nga shitja e aseteve	1,000	1,010	1,020	1,030	1,061	1,191	1,396
3	Të ardhura nga kopshtet, çerdhet, konviktet	11,800	12,980	13,629	14,310	15,026		
4	Të tjera	15,067	19,362	23,657	27,958	28,238		
D	Të ardhura të tjera	-	-	-	-	-	-	-
1	Dhurata/Sponsorizime	-	-	-	-	-	-	-
2	Donacione	-	-	-	-	-	-	-
3	Dividendë, KSHP	-	-	-	-	-	-	-
4	Kredi	-	-	-	-	-	-	-
E	Të ardhura të trashëguara	-	87,201	89,098	91,040	93,026	-	-
F	Taksa e tatime të ndara	19,700	21,670	22,537	23,438	24,610	26,568	31,247
G	Transferta e pakushtëzuar	432,622	441,274	450,100	459,102	468,284	525,364	616,124
H	Transferta e kushtëzuar	441,362	640,718	797,283	819,613	836,005	842,061	992,560
TOTALI		1,208,432	1,528,849	1,710,723	1,758,700	1,798,282	1,806,591	2,112,002

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

Shtojca 5. Parashikimi i shpenzimeve sipas kategorive Bashkia Berat, 2016 – 2030

	2016	2017	2018	2019	2020	2021-2025	2026-2030
Personel	257,051	195,469	198,904	204,731	210,669	214,463	224,329
Operative	422,968	498,104	506,857	521,707	536,837	526,610	538,410
Kapitale	603,207	817,701	982,860	1,005,902	1,036,079	1,019,453	1,115,450
TOTAL	1,283,226	1,511,273	1,688,620	1,732,341	1,783,584	1,760,526	1,878,189

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2016

8. Shënime dhe referenca

Manuali për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale, Co-PLAN 2008

Plani Strategjik i Zhvillimit dhe Buxhetimi Afatmesëm me Bazë Performancën, dldp 2012

Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Berat, Bashkia Berat 2016, përgatitur me asistencën e PLGP/USAID dhe Co-PLAN.

[1]Të ardhurat totale u ndanë në dy kategori: (i) kategoria e të ardhurave nga transferat ndërqeveritare ku u përfshinë të ardhurat nga transferta e kushtëzuar, transferta e pa kushtëzuar, transferta specifike (nga viti 2016) dhe të ardhurat nga taksa dhe tatime të ndara; (ii) kategoria e të ardhurave vendore ku u përfshinë të ardhurat nga taksat vendore, tarifat, të ardhurat nga asetet dhe të ardhura të tjera.

[2] Nëse nga të ardhurat nga burime të tjera apo nga totali i të ardhurave vendore të zbrisnim të ardhurat nga fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm do të kishim një panoramë deri diku ndryshe me taksat dhe tatimet, tarifat dhe të ardhurat nga astet me një peshë më të lartë ndaj totalit. Të ardhurat nga zëri i të ardhurave të tjera në këtë rast do të rezultonin të përfaqësonin vetëm 1.5% të të ardhurave vendore totale.

[3] Ligji Nr. 142/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9632/2006 "Mbi sistemin e taksave vendore".

[4] Për të lehtësuar përdorimin e dokumentit të PIK, në këtë kapitull janë bashkangjitur disa prej Fishave të Projekteve Kapitale të përgatitura nga Bashkia e Beratit, duke reflektuar në këtë mënyrë edhe projektet më strategjike të Bashkisë